

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Petplanet” SHPK

Ortaku themelues:

- z. Luan Ajeti, biri i Nazmiut dhe i Fetije, i datëlindjes 28.02.1982, lindur në Prishtinë dhe banues në Prishtinë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës numër P01565273 lëshuar nga Republika e Kosovës më datë 23-08-2019 dhe e vlefshme deri më 22-08-2029;

bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 04.08.2021, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

- 1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “Petplanet” SHPK
- 1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

NENI 2

Forma

- 2.1 Shoqëria tregtare “Petplanet” SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Petplanet” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën
Njësia Bashkiake nr.5, rruga "Abdyl Frashëri", godina 16, hyrja 1, apartamenti 7.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në fushën e tregtimit të ushqimit për kafshë, aksesore dhe pajisje për kafshë, barna për kafshe (zogj, peshq dhe zvarranike), preparate për higjenën e kafsheve (shampo).


NENI 5

Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “Petplanet” SHPK do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit



6.1 Shoqëria tregtare "Petplanet" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "Petplanet" SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Petplanet" SHPK është 1,000 (një mijë) lekë.

8.2 Ortaku i Vetëm i shoqërisë është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 1,000 (një mijë) lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm Luan Ajeti.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Afati i emërimit është 5 (pese)vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është zt Luan Ajeti, biri i Nazmi dhe i Fetije, i datëlindjes 28.02.1982, lindur në Prishtinë dhe banues në Prishtinë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës numër P01565273 lëshuar nga Republika e Kosoves më datë 23-08-2019 dhe e vlefshme deri më 22-08-2029.

Tirane.04/08/2021

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKU THEMELUES
Luan Ajeti

